



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:072910

Datë: 22.08.2024

Numri i dokumentit: 06074941

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Dardan Maloku, në çështjen penale ndaj të pandehurit E.A., me vendbanim në Rr. "...", Komuna Ferizaj, duke vendosur lidhur me marrëveshjen e ndërmjetësimit me nr. ND.../24, të datës 07.08.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurit E.A., në një të anë dhe përfaqësuesit të dëmtuarës KEDS – T.K., në anën tjetër, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.71-3/19 e datës 11.01.2019 për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 i KPRK-së dhe aktakuzës PP/II.nr.1337-4/19 e datës 07.08.2019, për shkak të veprave penale në vazhdim Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 dhe të KPRK-së, në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale (tani e tutje KPP) dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seance, më datë 22.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr.../2024, e datës 07.08.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, në mes të pandehurit E.A., me vendbanim në Rr. "...", te banesat e I., nr. ... në Ferizaj, i lindur me datë ..., me numër personal ..., në një të anë dhe të dëmtuarës KEDS, në anën tjetër.
- II. Hudhen** aktakuzat e Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.71-3/19 e datës 11.01.2019 dhe PP/II.nr.1337-4/19 e datës 07.08.2019, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit E.A., për shkak të veprave penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 i KPRK-së dhe veprës penale në vazhdim Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.
- III.** Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur 2 (dy) aktakuza ndaj të pandehurit E.A. lidhur me veprën penale Vjedhja e shërbimeve në vazhdim nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Në këtë seancën e shqyrtimit fillestar para leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, gjyqtari i çështjes i ka njoftuar palët se ndaj të pandehurit E.A. në këtë gjykatë zhvillohen edhe çështjet penale 2019:072911 dhe 2019:171001, andaj, gjykata ka marrë aktvendim me të cilin ka bashkuar procedurën penale lidhur me këto çështje penale.

Më datë 05.08.2024, është mbajtur shqyrtimi fillestar dhe në këtë shqyrtim fillestar bazuar në nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim palët kanë propozuar që kjo çështje penale të zgjidhet përmes procedurës së ndërmjetësimit. Gjykata e ka aprovuar propozimin e palëve dhe bazuar në nenin 229 paragrafi 1 të KPP-së, e ka referuar çështjen në ndërmjetësim.

Më datë 07.08.2024 në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr. .../2024, në mes të pandehurit E.A., me vendbanim në Rr. "...", te banesat e I., nr. ..., i lindur me datë ..., me numër personal ..., në njërën anë dhe të dëmtuarës KEDS, në anën tjetër.

Andaj, gjykata duke vepruar sipas dispozitave të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim KPP-në dhe me Ligjin për Ndërmjetësim, dhe kjo marrëveshje do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Nga të gjitha të lartcekurat, e në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

2019:072911, datë 22.08.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.